

VENDIM
Nr. 55, datë 29.3.2022

MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “DUFERCO SHQIPËRIA” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.3.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 406/1 prot., datë 24.3.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Duferco Shqipëria’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Duferco Shqipëria” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 314 prot., datë 25.2.2022, ka paraqitur aplikimin për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 314/1 prot., datë 9.3.2022, shoqëria “Duferco Shqipëria” sh.p.k. ka dokumentuar kryerjen e pagesës së aplikimit për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, sipas aneksit A, të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të ndryshuar.

- Duke marrë parasysh edhe pagesën e aplikimit të kryer nga shoqëria konform rregullores, u vijua shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar në ERE së fundi.

- Në zbatim të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal dhe dokumentacionin teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim, shoqëria ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, gjerat: “a”, “b”, “c”, plotësuar;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, gjerat “b” dhe “d”, plotësuar;
- dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8, gjerat: “a”, “b”, “c”, plotësuar.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2:
- gjerat “a”/“b” (akti i themelimit/statuti). Shoqëria duhet të paraqesë aktin e themelimit dhe statutin e saj në gjuhën shqipe, në përputhje me përcaktimin e nenit 8, pika 3, të rregullores së licencimit;
- germa “c” (vërtetim për regjistrimin dhe ekstraktin historik nga Qendra Kombëtare e Biznesit QKB). shoqëria duhet të përcjellë në ERE certifikatën e regjistrimit pranë QKB-së;

- germa “d” (vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë), shoqëria duhet të përcjellë në ERE vërtetimet e gjykatës dhe prokurorisë për vetë shoqërinë, administratorin e saj dhe dy përfaqësuesit ligjorë me autorizim, me data të rifreskuara sipas parashikimit në nenin 8, pika 3, të rregullores, citojmë se: “...ndërsa vërtetimet dhe deklaratat nga organe e tjera duhet të jenë lëshuar jo më parë se 1 muaj nga momenti i paraqitjes së aplikimit”. Saktësojmë se vërtetimi i prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për shoqërinë “Duferco

Shqipëria” sh.p.k., mban datën 3.2.2022 dhe është jashtë afatit të vlefshmërisë sikurse cituar në rregullore; vërtetimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shoqërinë “Duferco Shqipëria” sh.p.k., mban datën 10.1.2022 dhe është jashtë afatit të vlefshmërisë, sikurse cituar në rregullore; vërtetimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për administratorin e shoqërisë “Duferco Shqipëria” sh.p.k. mban datën 17.1.2022 dhe është jashtë afatit të vlefshmërisë, sikurse cituar në rregullore;

- germa “e” (struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse), shoqëria duhet të depozitojë strukturën e ndërtimit dhe funksionimit të saj.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3:

- germa “a” (vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe detyrimeve ndaj institucionit të sigurimeve shoqërore (për shoqëritë e sapokrijuara vërtetim që nuk ka detyrime)).

- Shoqëria ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore që mban datën 17.2.2022 dhe në zbatim të nenit 8, pika 3 të rregullores, ky vërtetim është brenda afatit të vlefshmërisë, sikurse cituar në rregullore dhe shoqëria “Duferco Shqipëria” sh.p.k. rezulton se nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar deri në datën e lëshimit të këtij vërtetimi, por mungon vërtetimi për shlyerjen e pagesave të sigurimeve shoqërore;

- germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financim dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacione, të tjera)).

Shoqëria ka paraqitur në ERE vërtetimin nr. 615, datë 23.2.2022, nga një bankë e nivelit të dytë mbi balancën e depozitave, pranë kësaj banke, por duhet të depozitojë informacion mbi aftësinë paguese dhe mbështetjen financiare të saj.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8:

- germa “b” (kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti). Shoqëria duhet të bëjë me dije se cili është kapitali financiar që vendos në dispozicion të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike. Për sa i përket mungesës në dokumentacion u konstatua se mungesat janë kryesisht të njëjta, si dhe në aplikimet e tjera që shoqëria “Duferco Shqipëria” sh.p.k. ka depozituar në ERE, me shkresën nr. 447 prot., datë 14.2.2020, nr. 447/2 prot., datë 28.5.2020, nr. 314/1 prot., datë 9.3.2022, e të konstatuara edhe në vendimet nr. 48/2020, nr. 86/2020, nr. 140/2020 dhe në vendimin nr. 264/2020.

- Shoqëria “Duferco Shqipëria” sh.p.k., në zbatim të parashikimit të nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, mund të paraqesë një aplikim të ri, brenda 1 (një) muaji nga marrja e vendimit të ERE-s për mosfillimin e procedurës dhe dokumentacioni i paraqitur në aplikimin e mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm edhe për aplikimin e ri.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mosfillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Duferco Shqipëria” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Në rast se shoqëria do të paraqesë një aplikim të ri, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijoni e këtij vendimi të Bordit të ERE-s, dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria, për qëllime të rinovimit të licencës, do të konsiderohet i vlefshëm.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti